



TË MOSHUARIT NË EPOKËN DIGJITALE

*Studim mbi dezinformimin dhe përdorimin
e mediave tek gjenerata e artë në Shqipëri*

PËRMBLEDHJE



Ky studim është për të moshuarit në Shqipëri dhe mënyrën se si ata përballen me dezinformimin dhe përdorimin e mediave në jetën e përditshme. Ai analizon burimet kryesore të informacionit, nivelin e besueshmërisë së tyre, ndjeshmërinë ndaj lajmeve të rreme dhe ndikimin që mashtrimet digjitale kanë në vendimet personale të gjeneratës së artë.

Studimi u zhvillua në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë, përmes një pyetësori me 207 të moshuar, duke sjellë një panoramë të qartë mbi sfidat e tyre në epokën digjitale.

GJETJET KRYESORE:

- Televizioni mbetet burimi më i besuar i informacionit për moshat e treta në Shqipëri (83.1%).
- WhatsApp (68.6%) dhe Facebook (59.9%) janë platformat kryesore të komunikimit.
- 57% e të moshuarve janë shumë të shqetësuar për përhapjen e lajmeve të rreme.
- Politika (74%) dhe shëndeti (71.6%) janë temat më të prekura nga dezinformimi.
- Vetëm 6.3% e të moshuarve verifikojnë gjithmonë informacionin para se ta shpërndajnë.
- Mbi gjysma e të moshuarve duan të mësojnë si të dallojnë informacionin e rremë.





KY STUDIM U REALIZUA NGA FAKTOJE, NË KUADËR TË PROJEKTIT “FUQIZIMI I GJENERATËS SË ARTË KUNDËR DEZINFORMIMIT”, I FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN.

Autore:

- Barbara Halla

Ekipi i anketuesve:

- Patris Pustina
- Pandi Gjata
- Esmeralda Topi

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e pyetësorit, të cilët ndanë përvojat e tyre dhe kontribuan me zërin autentik të gjeneratës së artë. Pa angazhimin e tyre, ky studim nuk do të kishte qenë i mundur.

Gjithashtu, një mirënjohje e veçantë për ekipin e Faktoje që mbështeti procesin e hartimit, analizës dhe publikimit të këtij raporti.

QERSHOR 2026



ZAKONET MEDIATIKE DHE EDUKIMI DIGJITAL TEK TË MOSHUARIT NË SHQIPËRI



HYRJE

Sipas censusit të vitit 2023, të moshuarit mbi moshën 55 vjeç përbëjnë 845,874 persona, ose rreth 35.2% të popullsisë në Shqipëri. Me një popullsi që po plakët dhe po zvogëlohet me shpejtësi, pesha e grupmoshës 55+ vazhdon të rritet, ashtu si edhe rëndësia e saj në jetën politike të vendit. Ky grup është gjithashtu më i ekspozuar ndaj manipulimit politik, propagandës, mashtrimeve dhe formave të tjera të rrezikut. Studime të ndryshme kanë treguar se shqiptarët në të gjitha grupmoshat përdorin internetin, dhe rrjetet sociale po bëhen gjithnjë e më të pranishme edhe në jetën e të moshuarve.

Megjithatë, ekziston një hendek i madh midis brezave që janë rritur me internetin dhe të moshuarve që e kanë përqaftuar botën digjitale më vonë. Ky grup është më i prirur të marrë lajme dhe argëtim nga media tradicionale, por më pak i ekspozuar ndaj teknikave të edukimit mediatik që ndihmojnë në vlerësimin e informacionit. Ky hendek, i rënduar nga kushtet e vështira ekonomike e sociale (varfëri, izolim, mungesë burimesh të besueshme), i ka bërë të moshuarit shqiptarë veçanërisht të cenueshëm ndaj dezinformimit. Megjithatë, mënyra se si dezinformimi ndikon tek të moshuarit në Shqipëri mbetet një fushë e pa studiuar mjaftueshëm, edhe pse pasojat e tij tashmë ndihen, qoftë në zgjedhje, shëndetësi apo fusha të tjera. Mungesa e studimeve të tilla ndikon edhe në aftësinë për t'iu përgjigjur sfidës që paraqet ky fenomen.

Ky studim synon të mbushë këtë boshllëk duke analizuar se si të moshuarit shqiptarë marrin dhe konsumojnë media, si ndërveprojnë me informacionin që marrin, dhe sa të aftë janë për të dalluar e përballuar dezinformimin dhe keqinformimin. Pyetësi i administruar gjatë muajve prill dhe maj 2026 synoi t'i përgjigjej pyetjeve:

- Çfarë burimesh përdorin shqiptarët mbi 55 vjeç për të marrë lajme dhe informacion?
- Sa shumë kanë integruar të rriturit shqiptarë mbi 55 vjeç rrjetet sociale dhe internetin në jetën e tyre të përditshme?
- Cilat burime informacioni i besojnë më shumë të rriturit shqiptarë mbi 55 vjeç?
- A janë të aftë të rriturit shqiptarë mbi 55 vjeç të verifikojnë informacionin dhe të dallojnë dezinformimin?
- Cilat metoda mësimi do të preferonin të rriturit shqiptarë mbi 55 vjeç për të fituar një nivel më të lartë edukimi mediatik?



MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE KUFIZIMET



Një pyetësor me 25 pyetje u realizua ballë për ballë me 207 të moshuar shqiptarë të moshës 55–75 vjeç. 25.9% ishin 55–64 vjeç, 36.6% ishin 65–74 vjeç, dhe 25.9% mbi 75 vjeç. 57.3% ishin gra, ndërsa 42.7% burra. Shumica kishin arsim të mesëm (39.6%), ndjekur nga arsim profesional (27.5%). Vetëm 11.6% kishin diplomë universitare, ndërsa 17.4% kishin ndaluar arsimin në shkollë fillore ose të mesme të ulët.

Të dhënat janë mbledhur nga katër zona kryesore urbane, çka përputhet me faktin se rreth 94% e të anketuarve e identifikuan zonën e tyre të banimit si urbane. Studiuesit e Faktosë zhvilluan intervista në qendra komunitare në Tiranë, Durrës dhe Korçë, si dhe në një shtëpi të moshuarish në Shkodër, duke synuar kështu të mbulojnë zonat kryesore gjeografike të vendit: veriu, qendrën dhe jugun e Shqipërisë.

Megjithëse pyetjet u përshtatën për t'u bërë sa më të kuptueshme, pati vështirësi në shpjegimin e konceptit të sondazhit dhe disa pyetje kërkuar shpjegime të gjata. Për shkak të kufizimeve të kohës dhe burimeve, sondazhi u kufizua vetëm në zonat urbane dhe pyetjet u fokusuan kryesisht tek zakonet e konsumit mediatic, jo tek përmbajtja specifike e dezinformimit apo ndikimi i tij në jetën e përditshme. Studime të tjera do të nevojiten për të analizuar më në detaje narrativat dhe dëmet e shkaktuara nga dezinformimi.



TELEVIZIONI VAZHDON TË JETË MEDIA E PREFERUAR TEK TË MOSHUARIT




GJETJET

99.6% e të moshuarve të intervistuar thanë se përdorin televizionin për të marrë lajme, krahasuar me 21.3% që përdorin gazeta. Rrjetet sociale (42%) dhe miqtë e familja (39.6%) janë gjithashtu burime të rëndësishme informacioni. Kjo gjetje përkon me studimet e mëparshme që tregojnë se shqiptarët, sidomos të moshuarit, shohin shumë televizion.


5. Cilat nga burimet e mëposhtme përdorni rregullisht për të marrë informacionet e përditshme?
(Mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

207 responses



8. Sa kohë kaloni duke parë televizor në ditë?

205 responses



Jo vetëm që të moshuarit shqiptarë kanë më shumë gjasa të marrin lajmet nga televizioni sesa nga rrjetet sociale, por ata gjithashtu kalojnë më shumë kohë duke parë TV sesa duke përdorur rrjete sociale apo duke marrë pjesë në aktivitete që u sjellin informacion. Megjithatë, një përmbledhje e përgjithshme tregon se shqiptarët kalojnë kohë të konsiderueshme si para televizorit ashtu edhe në rrjetet sociale. 39% thanë se shpenzojnë 3-4 orë në ditë duke parë televizion, ndërsa 24.9% thanë se e shohin TV për 1-2 orë në ditë. Një tjetër 22.9% e shohin TV për më shumë se 4 orë në ditë. Për më tepër, televizioni dhe programet televizive renditen të dytat pas miqve dhe familjes si burime të besueshme informacioni. 83.1% e shqiptarëve të anketuar thanë se e konsiderojnë TV ndër dy burimet më të besueshme të informacionit.


RRJETET SOCIALE JANË GJITHNJË E MË TË RËNDËSISHME, POR TË PABESUESHME



Rrjetet sociale dhe interneti po marrin një rol gjithnjë e më të madh në jetën e të moshuarve shqiptarë. 32.4% deklarojnë se marrin informacion nga faqet e lajmeve online dhe 42% përmendën përdorimin e rrjeteve sociale. Ne kemi llogaritur aplikacionet e mesazheve si WhatsApp si pjesë të rrjeteve sociale, dhe në fakt 68.6% e të anketuarve përmendin se përdorin WhatsApp, të ndjekur nga Facebook (59.9%), YouTube (55.1%) dhe Instagram (24.6%). Një përqindje e vogël (14%) përmendin përdorimin e TikTok, i cili së fundmi ishte i ndaluar në Shqipëri. 31.9% e të anketuarve thonë se kalojnë 1–2 orë në ditë në rrjete sociale, ndërsa 30.4% pohojnë se kalojnë 3–4 orë. 10.6% u përgjigjën se kalojnë më shumë se 4 orë në ditë në rrjete sociale.


6. Cilat rrjete sociale përdorni?

207 responses



7. Sa kohë shpenzoni online në ditë?

207 responses



Megjithëse përdorimi i rrjeteve sociale dhe internetit po rritet, ato renditen shumë ulët për sa i përket besueshmërisë tek të moshuarit shqiptarë. Të pyetur për besueshmërinë e faqeve të lajmeve online, 53 anketuar i konsideruan ato jo shumë të besueshme, ndërsa 75 thanë se nuk janë aspak të besueshme. Po kështu edhe për lajmet e shpërndara përmes rrjeteve sociale: 58 thanë se i gjejnë jo shumë të besueshme, ndërsa 73 thanë se nuk janë aspak të besueshme. Ky mosbesim ndaj rrjeteve sociale mund të jetë rezultat i një mosbesimi të trashëguar ndaj internetit. Studime të ardhshme duhet të eksplorojnë se çfarë e nxit këtë dinamikë, duke pasur parasysh se edhe lajmet në televizionin shqiptar kanë një prani të lartë të keqinformimit dhe dezinformimit.

KOMUNITETI VAZHDON TË JETË SHUMË I RËNDËSISHËM PËR BESIMIN DHE SHPËRNDARJEN E INFORMACIONIT




Ndërsa të moshuarit shqiptarë mbështeten si tek televizioni ashtu edhe tek rrjetet sociale për të marrë lajme, ata varen shumë edhe nga komuniteti i tyre. 39.6% thanë se marrin informacion dhe lajme nga miqtë dhe familja. Miqtë dhe familja renditen gjithashtu shumë lart për sa i përket besueshmërisë tek të moshuarit shqiptarë. Nga 207 persona të intervistuar, 148 thanë se i konsiderojnë miqtë dhe familjen burime shumë të besueshme informacioni, dhe 38 thanë se janë disi të besueshëm. Vetëm 21 i renditën si jo shumë të besueshëm ose më pak. 50.7% e të anketuarve i renditën miqtë dhe familjen ndër dy burimet më të besueshme të informacionit, së bashku me televizionin dhe programet televizive.

9. Sa të besueshme i konsideroni burimet e mëposhtme? (Zgjidhni një përgjigje për çdo rresht)



10. Cilave burime i besoni më shumë? (Zgjidhni vetëm 2)

207 responses



Rëndësia e komunitetit tek të moshuarit shqiptarë ka rrënjë historike, megjithatë nevojiten më shumë kërkime për të kuptuar se si ndërtohet dhe ruhet ky besim, por edhe pse ndonjëherë mund të jetë i rrezikshëm dhe jo i padëmshëm, sidomos kur komuniteti është po aq i cenusshëm ndaj keqinformimit dhe dezinformimit. Megjithatë, fakti që komuniteti është një burim i rëndësishëm informacioni, dhe konsiderohet shumë i besueshëm, duhet të merret parasysh kur hartohen politika dhe programe që synojnë rritjen e edukimit mediatic tek shqiptarët mbi moshën 55 vjeç.


DEZINFORMIMI SHQETËSON SHUMICËN E TË MOSHUARVE



57% e të moshuarve të anketuar nga Faktaje raportuan se ndihen shumë të shqetësuar për dezinformimin në median që konsumojnë. 30.4% e përkrauan veten si disi të shqetësuar. Për më tepër, 49.8% besojnë se e hasin dezinformimin shumë shpesh, ndërsa 21.7% besojnë se e hasin vetëm ndonjëherë. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të kuptuar pse të moshuarit shqetësohen nga dezinformimi dhe si e shohin ata ndikimin e tij në jetën e tyre.

11. Sa i/e shqetësuar jeni për përhapjen e lajmeve të rreme/mashtrimeve?


207 responses



- Shumë i/e shqetësuar
- Disi i/e shqetësuar
- Pak i/e shqetësuar
- Aspak i/e shqetësuar

12. Sa shpesh mendoni se hasni informacione të rreme?

207 responses



- Shumë shpesh
- Ndonjëherë
- Rrallë
- Asnjëherë
- Nuk jam i/e sigurt




TË MOSHUARIT E SHOHIN VETEN SI TË CENUESHËM NDAJ DEZINFORMIMIT, POR NUK KANË MJETET PËR TA IDENTIFIKUAR OSE PËR TA DEMASKUAR

Po ashtu, 50% e të moshuarve të anketuar besojnë se janë shumë të cenueshëm ndaj dezinformimit, ndërsa 27.7% mendojnë se janë disi të cenueshëm. Kur bëhet fjalë për verifikimin e informacionit ose dallimin e dezinformimit, 33.3% e të moshuarve thanë se nuk përpiqen kurrë të verifikojnë informacionin që marrin, dhe 26% thanë se e bëjnë këtë vetëm rrallë herë. Vetëm 6.3% raportuan se e verifikojnë pothuajse gjithmonë, ndërsa 19.8% thanë se e bëjnë rregullisht.

Për më tepër, 61.5% e të anketuarve thanë se nuk janë të sigurt nëse ndonjëherë kanë shpërndarë dezinformim, duke treguar se shumë prej tyre nuk kanë mjetet për ta dalluar ose verifikuar atë. 15.6% thanë se po, ndërsa 22.9% thanë se jo. Nga ata që iu përgjigjën “po” pyetjes nëse kishin shpërndarë dezinformim në të kaluarën, shumica e kuptuan se ishte e gabuar kryesisht kur dikush në jetën e tyre i korrigjoi. Në fakt, 63.9% thanë se e zbuluan pasi dikush ua tha, dhe vetëm 13.1% sepse ishte korrigjuar në media.

13. Sa të ndjeshëm mendoni se jeni ndaj lajmeve të rreme/mashtrimeve?

206 responses




TË MOSHUARIT E SHOËIN VETEN SI TË CENUESHËM NDAJ DEZINFORMIMIT, POR NUK KANË MJETET PËR TA IDENTIFIKUAR OSE PËR TA DEMASKUAR

Të pyetur për aftësinë e tyre për t'u përballur me dezinformimin, shumica e të moshuarve duken të pasigurt në lidhje me përdorimin e mjeteve të nevojshme për ta bërë këtë. Shumica thanë se nuk ishin shumë të sigurt ose aspak të sigurt se si të gjenin informacion online, si të gjykonin nëse ai informacion ishte i vërtetë, si të identifikonin nëse një burim ishte i besueshëm, ose si të zgjidhnin çfarë të shpërndanin (qoftë online apo me të tjerët).


Në fakt, 62.3% e të moshuarve u përgjigjën se nuk dinin si të verifikonin nëse një informacion ishte i vërtetë apo jo. Ndërkohë 32.4% thanë se ishin disi të sigurt se mund ta bënë këtë. 51.2% raportuan gjithashtu se nuk ishin të sigurt nëse dezinformimi u kishte bërë ndonjëherë të ndryshonin mendje për diçka. Ndërsa 38% thanë se kishin ndryshuar mendim bazuar në informacion që më vonë rezultoi i pavërtetë.

18. Sa i/e sigurt ndiheni në aftësinë tuaj për të: (Rrethoni një përgjigje për çdo rresht)



19. A dini si të kontrolloni nëse një lajm është i saktë?

204 responses




SHËNDETI, POLITIKA DHE EKONOMIA JANË NDËR TEMAT QË SHQETËSOJNË MË SHUMË TË MOSHUARIT

Ndërsa 46.3% e të moshuarve nuk ishin të sigurt nëse dezinformimi kishte ndikuar në vendimmarrjen e tyre lidhur me shëndetin, votimin apo financat, shumica kanë ndjesinë se dezinformimi duhet t'i ketë ndikuar në një moment apo tjetër pa e vënë re. Shëndeti dhe politika shihen si fushat më të rrezikuara, me 74% të të anketuarve që besojnë se politika është një qendër kryesore e dezinformimit, e ndjekur nga shëndeti (71.6%), ekonomia (30.9%) dhe feja (19.1%). Të anketuarit kishin mundësinë të zgjidhnin sa opsione të dëshironin.

Ky rezultat nuk është i papritur, duke marrë në konsideratë prevalencën e mashtrimeve shëndetësore tek të moshuarit dhe faktin që kompanitë e mjekësisë alternative reklamojnë në televizionet shqiptare pa mbikëqyrje rregullatore mbi pretendimet e tyre.

22. Cilat tema mendoni se preken më shumë nga lajmet e rreme? (Mund të zgjidhni disa opsione)

204 responses




SHUMICA E TË MOSHUARVE DUAN TË MËSOJNË EDUKIM MEDIATIK PËRMES TV APO AKTIVITETEVE KOMUNITARE

54.1% e të moshuarve thanë se do të ishin të interesuar të mësonin më shumë rreth mënyrës se si të dallojnë dezinformimin, ndërsa 38% thanë se ishin disi të interesuar. Kur u pyetën se cilat metoda do të preferonin për të mësuar rreth kësaj, aktivitetet e bazuara në komunitet dolën si opsioni më i popullarizuar, të zgjedhura nga 56.8% e pjesëmarrësve. Programet televizive (38.7%) dhe trajnimet me specialistë (32.2%) gjithashtu u vlerësuan lart.

Programet online nuk u preferuan fare (vetëm 3.5% e zgjodhën si opsion). Të moshuarit gjithashtu nuk i besojnë institucioneve shtetërore për t'ua ofruar këtë informacion, duke preferuar në vend të tyre gazetarët (51.5%), si dhe OJQ-të (29.4%) dhe mësuesit (32%).


24. Çfare metodash do të preferonit per të mësuar?

199 responses



25. Nëse këto tranjime do të merrnin pjesë, kujt do t'i besonit më shumë për organizimin e tyre?

194 responses



DISKUTIMI I GJETJEVE



Ky studim është një hap i parë që nxjerr në pah nevojën për kërkime më të gjata dhe më të gjera mbi këtë temë. Duhet të alokohen burime për ta zgjeruar studimin edhe në zonat rurale të Shqipërisë, gjë që do të kërkonte mbështetje logjistike dhe një afat më fleksibël, duke pasur parasysh sfidat e mbledhjes së të dhënave nga popullata e moshuar, veçanërisht ata që jetojnë në zona të izoluara. Studime të ardhshme duhet gjithashtu të eksplorojnë më në thellësi llojet specifike të keqinformimit dhe dezinformimit që hasin të moshuarit, narrativat që rezonojnë më fort me ta, si dhe efektet e prekshme që këto mund të kenë në pjesëmarrjen e tyre politike, vendimet shëndetësore, mirëqenien financiare dhe marrëdhëniet shoqërore.

Pasiguria del si tema kryesore e këtij sondazhi. Shumë të anketuar nuk ishin të sigurt nëse kishin hasur dezinformim, nëse e kishin shpërndarë, si ta verifikonin informacionin, apo nëse informacioni i rremë kishte ndikuar në mendimet dhe vendimet e tyre. Kjo pasiguri nuk duhet interpretuar si indiferencë. Përkundrazi, të anketuarit shprehën nivele të larta shqetësimi për dezinformimin dhe një vetëdije të fortë për cenueshmërinë e tyre ndaj tij. Gjetjet sugjerojnë se shumë të moshuar shqiptarë e njohin ekzistencën e problemit, por u mungon besimi dhe aftësitë praktike të nevojshme për ta adresuar.

Studimi gjithashtu nxjerr në pah një paradoks të dukshëm në zakonet mediatike të të moshuarve shqiptarë. Ndërsa televizioni mbetet burimi dominues i lajmeve dhe informacionit dhe gëzon nivele të larta besimi, platformat e rrjeteve sociale dhe aplikacionet e mesazheve janë bërë pjesë e pandashme e jetës së përditshme të shumë të anketuarve. Në të njëjtën kohë, rrjetet sociale dhe faqet e lajmeve online janë gjerësisht të pabesueshme. Kjo sugjeron se të moshuarit vazhdojnë të konsumojnë informacion përmes kanaleve digjitale pavarësisht dyshimeve për besueshmërinë e tyre. Një dinamikë e tillë krijon një mjedis ku keqinformimi mund të qarkullojë gjerësisht edhe mes individëve që pretendojnë se janë skeptikë ndaj përmbajtjes online. Vetëm mosbesimi nuk mjafton për të siguruar verifikim të saktë.

Një gjetje tjetër e rëndësishme ka të bëjë me rolin qendror të rrjeteve sociale dhe marrëdhënieve komunitare. Miqtë dhe familja nuk janë vetëm ndër burimet më të zakonshme të informacionit, por edhe ndër më të besuarat. Ky fakt është veçanërisht domethënës sepse tregon se shpërndarja e informacionit tek të moshuarit shpesh ndodh përmes marrëdhënieve ndërpersonale dhe jo ekskluzivisht përmes kanaleve mediatike. Ndërsa rrjete të tilla mund të ofrojnë mbështetje shoqërore dhe udhëzime të besueshme, ato gjithashtu mund të amplifikojnë keqinformimin kur informacioni i pasaktë qarkullon mes njerëzve që i besojnë njëri-tjetrit. Fakti që shumica e të anketuarve që kuptuan se kishin shpërndarë informacion të rremë e zbuluan këtë sepse dikush i korrigjoi, ilustron më tej rëndësinë e besimit ndërpersonal në formësimin e sjelljes informative.



DISKUTIMI I GJETJEVE



Gjetjet gjithashtu tregojnë një hendek të madh midis vetëdijes për dezinformimin dhe aftësisë praktike për t'iu përgjigjur atij. Shumica shprehën shqetësim për informacionin e rremë dhe pranuan cenueshmërinë e tyre, por relativisht pak raportuan se verifikojnë rregullisht informacionin. Shumë prej tyre nuk kishin besim në aftësinë për të përcaktuar nëse një burim është i besueshëm ose nëse një pretendim është i vërtetë. Ky hendek tregon se ndërhyrjet për edukimin mediatik duhet të fokusohen jo vetëm në rritjen e vetëdijes, por edhe në ndërtimin e aftësive praktike të përditshme.

Dominimi i temave të shëndetit, politikës dhe ekonomisë ndër shqetësimet e të anketuarve meriton vëmendje të veçantë. Këto tema kanë pasoja të drejtpërdrejta për cilësinë e jetës dhe janë fusha ku informacioni i pasaktë mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme.

Dezinformimi i lidhur me shëndetin mund të ndikojë në vendimet e trajtimit dhe t'i ekspozojë të moshuarit ndaj mashtrimeve, ndërsa dezinformimi politik mund të ndikojë në pjesëmarrjen zgjedhore dhe angazhimin demokratik. Dezinformimi ekonomik mund t'i bëjë të moshuarit të cenueshëm ndaj mashtrimeve financiare dhe investimeve të rreme, një problem i përhapur në Shqipëri ku qendrat e thirrjeve janë shtuar vitet e fundit, duke punësuar shumë të rinj dhe duke vepruar me pak etikë dhe pa shumë rregulla.

Gjetjet ofrojnë gjithashtu udhëzime të vlefshme për politikëbërësit, gazetarët, arsimtarët dhe organizatat e shoqërisë civile për të fuqizuar mbrojtjen ndaj dezinformimit. Të anketuarit shprehën një preferencë të qartë për të mësuar përmes aktiviteteve komunitare, programeve televizive dhe trajnimeve në person. Shumë pak preferuan kurse online ose mjete digjitale të të nxënit. Kjo tregon se programet e edukimit mediatik për të rinjtë nuk funksionojnë njësoj për të moshuarit. Në vend të tyre, ndërhyrjet duhet të ofrohen përmes kanaleve që të moshuarit tashmë i përdorin dhe u besojnë.

Së fundi, rezultatet sfidojnë supozimet se të moshuarit janë konsumatorë pasivë të informacionit ose të paaftë për të mësuar aftësi të reja. Interesi i fortë i shprehur nga të anketuarit për të marrë trajnim në edukim mediatik tregon se ka shumë nevojë për mundësi të tilla mësimi. Në vend që të shihen vetëm si një popullatë e cenueshme, nismat e ardhshme duhet t'i njohin të moshuarit si pjesëmarrës aktivë, të motivuar për të përmirësuar aftësinë e tyre për të naviguar në një mjedis informacioni gjithnjë e më kompleks.

Të marra së bashku, këto gjetje sugjerojnë se sfida e dezinformimit tek shqiptarët e moshuar lidhet më pak me aksesin në informacion dhe më shumë me besimin, aftësitë e verifikimit dhe sistemet e mbështetjes së besueshme. Trajtimi i këtyre çështjeve do të kërkojë qasje të synuara dhe të ndjeshme ndaj moshës, të cilat ndërtojnë mbi zakonet mediatike dhe marrëdhëniet shoqërore që tashmë formësojnë mënyrën se si të moshuarit marrin dhe vlerësojnë informacionin.





*Ky studim është prodhuar në kuadër të nismës
"Empowering the Golden Generation Against
Disinformation", mbështetur financiarisht nga
Bashkimi Evropian*



Funded by
the European Union

Fakt^oje.al